



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 510/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vlastimir Dimić dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Fryma e Re (FER) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër kryekomisionerit Albert Haxhia anetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

REUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Fryma e Re (FER).

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga subjekti politik FER, ne te cilën pretendohet se “me datë 12.12.2010, rreth orës 17:00, ne shkollën Hadar Dushi, Gjakove, VV nr. 0201/08D kryekomisioneri Albert Haxhia ka lejuar votimin me kusht te te mitures Sinavere Sopjani me date te lindjes 13/08/1993, edhe pse ka pasur kundërshtime nga ana e komisionereve te tjere”.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë, përveç se ka siguruar numër kontakt te Simona Bejtullaku (komisioneve e FER), Art Bejtullaku (vëzhgues i FER) dhe Dielleza Raci nga Demokracia ne Veprim, ne cilësinë e dëshmitarit.

Me rëndësi është fakti se PZAP është informuar prej organeve policore, përkatësisht nëpërmjet raportit policor te leshuar nga oficeri Shefri Musaj nr. identifikimi 3660, se ne shkollën Hajdar Dushi QV Nr. 0201/08D, ne lidhje me ankesen me numër lende A510, procesi zgjedhor është zhvilluar ne mbarëvajtje te plote dhe nuk është regjistruar asnjë problem, ku deri ne orën 17:00 kane votuar 2519 persona dhe menaxheri i QV ka pohuar se situata ka qene ne kontroll dhe pa asnjë problem ne lidhje me procesin e votimit.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh si vijon:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

- ankesa është e pabazuar.

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës janë të pabazuara për shkakun se nuk është ofruar asnjë dëshmi apo prova të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur shkelja e pretenduar nga subjekti politik FER. Ky fakt konfirmohet edhe përmes organe policore, të cilët theksojnë se në VV nr. 0201/08D, dt, 12.12.2010, ora 17:00 nuk pasur asnjë problem në lidhje me procesin e votimit. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuara më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 510/2010 më datën 16.12.2010.

